

**STATUT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Natura Resort" SH.P.K**

Ky statut perpilohet nga :

**Shoqeria tregtare "R & T" Sh.p.k.** me seli ne adresen Rr. "Luigj Gurakuqi", Pallati 89, Shk.A, Kati 10, Tirane, regjistruar si person juridik sipas ligjeve shqiptare me ane te Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me nr. 12540, date 23.10.1995 dhe regjistruar ne Organet Tatimore me NUIS Nr. J61901094G, perfaqesuar me vendim te ortakut te vetem nga Ortaku i vetem dhe administratori i saj z. **Renis TËRSHANA** lindur me 23.09.1971, ne Tirane, me Leternjoftim nr. 032980763 dhe nr. personal H10923040R. banues ne Rr. "e Elbasanit", Pll. "Tershana 2", Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar

**Shoqeria tregtare "TURBOO ALBANIA" Sh.p.k** me seli ne adresen Njesia Bashkiake nr.10, Rr. "Kavajes" (Ish Kinema Republika), Pallati i ri ish Teoren, Tregu Came, kati - 1. Tirane, regjistruar si person juridik sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Organet Tatimore me NUIS Nr. L82202054O, perfaqesuar nga Ortaku i Vetem dhe aministratori i saj **znj. Sindi Xhillari**, lindur ne 08.01.1995, e pajisur me Leternjoftim nr.038069077 dhe nr. personal J55108044M, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Te quajtur me poshte ortaket themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, si vijon:

**KREU I**

**NENI 1  
FORMA**

Ortaket krijojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2  
EMRI I SHOQERISE**

Emri i shoqerise do te jete "Natura Resort" SH.P.K..

**NENI 3  
SELIA E SHOQERISE**

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne Rr. "Luigj Gurakuqi", Pallati 89, Shk.A, Kati 10, Tirane.

Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege. zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

**NENI 4  
KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar.



**NENI 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqeria do te kete per objekt veprimtarie:

Projektimin, investimin, zhvillimi/ndertimi, operimin sipas projekteve, studimeve te miratuara dhe lejeve te zhvillimit qe do te jepen nga organet kompetente, me qellim ndertimin e strukturave me destinacion turizmin, ambjenteve te rekreacionit, apartamente dhe/ose banesa individuale pushimi, hotel, perfshire cdo lloj ambjenti aksesor ne funksion te tyre, etj ne zonen e Poro - Vlore s he cod objekt tjeter veprimtrie qe lidhet me sa me siper apo dhe cdo objekt tjeter qe nuk ndalohet me ligj.

**KREU II**

**KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT  
THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

**NENI 6**

Kapitali themeltar shoqerise eshte 100,000 (njeqind mije) Leke i ndare ne kuota si me poshte:

1. **R & T” Sh.p.k**, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 54 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **“TURBOO ALBANIA” Sh.p.k**, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 46 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

**NENI 7**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen:

1. **“R & T” Sh.p.k**, 54 % te fitimit te realizuar.
2. **“TURBOO ALBANIA” Sh.p.k**. 46 % te fitimit te realizuar.

**NENI 8**

**TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR**

Duke qene se ortakët jane persona juridike, atehere secili nga ata mund te trasferojne nje pjese apo te gjithë kuoten qe zoterojne ne shoqeri vetem personave te rrethit te ngushte familjar te ortakut te vetem qe rezulton ne momentin e themelimit te kesaj shoqerie.

Ne rast se ortakët deshironë t'i transferojne nje pjese apo te gjithë kuoten qe ata zoterojne ne shoqeri, nje personi fizik apo juridik jashte rrethit te bashkeortakeve, ortakët qe deshiron te transferoje kuoten duhet t'i drejtohet me nje kerkese Ortakut tjeter te shoqerise me ane te se ciles t'i bej te ditur sasine e kuotes, cmimin dhe personin fizik apo juridik te cilit do t'ia transferoje. Ortaku te cilit i drejtohet kerkesa eshte i detyruar qe brenda nje afati tre mujor t'i ktheje pergjigje ortakut qe deshiron te transferoje kuoten, nese deshiron t'i bleje vete kuotat me te njetat kushte apo jo. Ne rast se brenda afatit Ortaku te cilit i drejtohet kerkesa nuk kthen pergjigje atehere tranferimi do te konsiderohet si i pamiratuuar dhe ortakët qe deshiron te transferoje kuoten nuk mundet dot te kryej transferimin.



Ortakët mund të dakortësojnë për shitjen bashkarisht të kuotave që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë një personi të tretë fizik apo juridik.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh juridike mes të gjalleve dhe me trashëgimi. Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë nuk i nënshtrohet asnjë lloji kufizimi, në qoftë se ndodh në rast vdekjeje.

### **KREU III**

#### **MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË**

##### **NENI 9**

##### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të secilit.

##### **NENI 10**

##### **DREJTIMI I SHOQËRISË**

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë asambleja e ortakëve. Asambleja e ortakëve mbledhet si rregull dy herë në vit, si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesën e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi dërgohet në adresën zyrtare të secilit ortak dhe dyhet të garantohet identifikimi i marresit.

Kuorumi dhe vendimarrja bëhet sipas dispozitave ligjore.

Për çështje teknike që kanë të bëjnë paraqitjen për miratim të projekteve, studimeve, masterplaneve etj që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë vendimet do të merren bashkarisht nga dy ortakët. Në rast mos dakordësie në vendimarrje do të prevalojë vota Ortakut që zotëron më shumë se 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

##### **NENI 11**

##### **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË ORTAKEVE**

Asambleja e ortakëve vendos për këto çështje:

- Emeron administratorin e shoqërisë.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos për shpërndarjen e dividendit të shoqërisë.
- Ben ndryshime në statut.
- Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar.
- Vendos për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
- Si dhe per cdo ceshtje qe gjykon te aresyeshme
- Vendimet e asamblese nenshkruhen nga ortaket apo perfaqesuesit e tyre.

### NENI 12 ADMINISTRATORI

Shoqeria do te administrohet nga z. Renis Tershana per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhje.

### NENI 13 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqerise emerohet nga asambleja e ortakeve dhe pergjigjet per zbatimin e vendimeve te asamblese se ortakeve.

Administratori ka keto kompetenca :

- Te beje drejtimin e shoqerise .
- Te perpiloje dhe nenshkruaje kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise;
- Te hapi llogari rrjedhese bankare prane bankave te nivelit te dyte, shqiptare ose te huaja.
- Te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet.
- Te emeroje nenpunes te rangjeve te ndryshme per veprime te vecanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh;
- Te beje gjithcka tjeter qe konsiderojne te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

### KREUI V LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

#### NENI 14

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacinit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

- 1- Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Admimstratoreve.
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

### NENI 15 VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar do te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor te atij viti. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vecanta te hartuara nga admimstratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i




dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylles se vitit financiar.

## KREU V

### NENI 16 AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim Bilancit i bashkengjiten:

- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,
- b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria,

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylles se vitit financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

### NENI 17

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

### NENI 18 PRISHJA e SHOQERISE

Shoqeria priset per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese Ortakeve .

### NENI 19

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

### NENI 20

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

### NENI 21

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emerone nje ose disa persona si likuidues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

### NENI 22

Ne perfundim te mbylljes se likuidimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likuiduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e Ortakeve .

### NENI 23

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

### NENI 24

#### DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit. Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Kur mosmarreshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

### NENI 25

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakeve themelues.

31.12./2022

#### THEMELUESIT

Shoqeria "R & T" Sh.p.k  
Administrator  
Renis TËRSHANA

Shoqeria "TURBOO ALBANIA " Sh.p.k  
Administrator  
Sindi XHILLARI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQERIA TREGTARE  
"R & T" Sh.p.k.

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM  
DATE 31 / 12 / 2022

Shoqeria tregtare "R & T" Sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik sipas ligjeve shqiptare me ane te Vendimit te Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane me nr. 12540, date 23.10.1995 dhe regjistruar ne Organet Tatimore dhe QKB me NUIS Nr. J61901094G, me seli ne adresen Rr. "Luigj Gurakuqi", Pallati 89, Shk.A, Kati 10, Tirane.

Ne mbledhje e sotme ortaku i vetem/ administrator mori ne shqyrtim rendin e dites:



- Pjesmarrjen si ortak ne shoqerine e re qe do te krijohet bashke me ortakun tjeter shoqerine "Turboo Albania" Sh.p.k

Ne perfundim ne baze te statutit te shoqerise dhe ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 ortaku i vetem:

VENDOSI

- Pjesmarrjen si ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 54% te kapitalit themeltar te shoqerise e re qe do te krijohet bashke me ortakun tjeter shoqerine "Turboo Albania" Sh.p.k
- Administratori shoqerise njekohesisht edhe ortak i vetem te vendose per cdo klauzole te Statutit te shoqerise si dhe te nenshkruaje Statutin e shoqerise.

Shoqeri R & T sh.p.k  
Ortaku i Vetem  
Renis TËRSHANA

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQERIA TREGTARE  
"TURBOO ALBANIA" Sh.p.k

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM  
DATE 31 / 12 / 2022

Shoqeria tregtare "TURBOO ALBANIA" Sh.p.k me seli ne adresen Njesia Bashkiake nr.10, Rr. "Kavajes" (Ish Kinema Republika), Pallati i ri ish Teoren, Tregu Came, kati - 1, Tirane, regjistruar si person juridik sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Organet Tatimore me NUIS Nr. L822020540.

Ne mbledhje e sotme ortakut i vetem/ administrator mori ne shqyrtim rendin e dites:

- Pjesmarrjen si ortak ne shoqerine e re qe do te krijohet bashke me ortakun tjeter shoqerine "R & T" Sh.p.k

Ne perfundim ne baze te statutit te shoqerise dhe ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 ortakut i vetem:

#### VENDOSI

- Pjesmarrjen si ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 46% te kapitalit themeltar te shoqerise e re qe do te krijohet bashke me ortakun tjeter shoqerine "R & T" Sh.p.k
- Administratori shoqerise njekohesisht edhe ortak i vetem te vendose per cdo klauzole te Statutit te shoqerise si dhe te nenshkruaje Statutin e shoqerise.

Shoqeri "Turboo Albania" sh.p.k

Ortaku i Vetem  
Indi XHILARI  
NUIS: L822020540  
TURBOO ALBANIA  
Sh.p.k.  
TIRANE